

Nr. prot 603
Dt. 26/09/2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 1146 / prot.
3

Tiranë, më 21.9 .2022

Lënda: Dërgohet për njohje dhe zbatim

Z. ALTIN BASHA, DREJTOR
TEATRI KOMBËTAR EKSPERIMENTAL "KUJTIM SPAHIVOGLI"
Rruga "Sami Frasheri", 1001 Tiranë

I nderuar z. Basha,

Bashkëngjitur gjeni për njohje dhe zbatim urdhrin nr.630, datë 19.09.2022 të Ministrit të Kulturës "Për miratimin e statutit të Teatrit Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli"".

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
Zerina BRUCI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

MINISTRI

Nr. 4146 / prot
2

Tiranë, më 19.9.2022

URDHËR

Nr 630, datë 19.9.2022

PËR

MIRATIMIN E STATUTIT TË TEATRIT KOMBËTAR EKSPERIMENTAL “KUJTIM SPAHIVOGLI”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 dhe nenit 119 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 10 352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën” i ndryshuar, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, urdhrin e Kryeministrit nr. 3119/1, datë 25.08.2014 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Teatrit Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”.

URDHËROJ:

1. Miratimin e Statutit të Teatrit Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”, bashkëlidhur këtij urdhri
2. Ngarkohen punonjësit e Teatrit Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”, për zbatimin e këtij urdhri, si dhe Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Kulturës për komunikimin e tij.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Elva Margariti





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
TEATRI KOMBËTAR EKSPERIMENTAL "KUJTIM SPAHIVOGLI"

STATUTI I TEATRIT KOMBËTAR EKSPERIMENTAL "KUJTIM SPAHIVOGLI"

MIRATOI

MINISTËR



Elva Margariti

Tabela e Përmbajtjes

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME.....	3
Neni 1 Objekti	3
Neni 2 Statusi juridik.....	3
Neni 3 Parimet.....	4
Neni 4 Stema, vula zyrtare dhe logoja.....	4
Neni 5 Selia.....	4
Neni 6 Kohëzgjatja.....	4
KREU II ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I TEATRIT KOMBËTAR EKSPERIMENTAL "KUJTIM SPAHIVOGLI"	4
Neni 7 Strukturat organizative.....	4
Neni 8 Detyrat e TKEKS	5
Neni 9 Bordi Artistik i TKEKS.....	5
KREU III DREJTIMI, MARRËDHËNIET E PUNËSIMIT, DHE DETYRAT E DREJTORIT...6	
Neni 10 Drejtimi.....	6
Neni 11 Detyrat e Drejtorit.....	7
Neni 12 Marrëdhëniet e punësimit.....	8
KREU IV ADMINISTRIMI FINANCIAR.....	8
Neni 13 Të ardhurat buxhetore.....	8
Neni 14 Hartimi i projekt buxhetit.....	9
Neni 15 Auditimi financiar.....	9
KREU V DISPOZITA TË FUNDIT.....	9
Neni 16 Ndryshimet në Statut.....	9
Neni 17 Hyrja në fuqi.....	9

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

1. Ky statut përcakton parimet bazë të procedurave institucionale, administrative dhe operative të Teatrit Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli", në vijim "TKEKS".

Neni 2

Statusi juridik

1. TKEKS, është krijuar dhe funksionon në bazë të ligjit nr. 10 352 datë 18.11.2010 "Për Artin dhe Kulturën" i ndryshuar, urdhrin e Kryeministrit nr. 201, datë 25.08.2014 "*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Teatrit Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli"*".
2. TKEKS, është institucion kombëtar, me organizim në nivel qendror, në varësi të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën si dhe financohet nga buxheti i shtetit dhe burime të tjera të ligjshme.
3. TKEKS e ushtron aktivitetin në mbështetje dhe në zbatim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të dispozitave e legjislacionit në fuqi për artin dhe kulturën, të legjislacionit shqiptar në fuqi, këtë statut si dhe të rregullores së brendshme të funksionimit të tij.

Neni 3

Misioni

1. Misioni i TKEKS-së është krijimtaria teatrore ku gjallojnë format e shprehjes teatrore duke vënë në skenë të gjitha gjinitë teatrore, të fondit teatror shqiptar dhe botëror përmes punës inovative dhe zhvillimit të koncepteve të reja dhe teknikave në produksionet skenike.
2. TKEKS në veprimtarinë e tij zbaton strategjinë e Ministrisë së Kulturës në fushën e artit dhe kulturës dhe propozon politika nxitëse dhe mbështetëse për zhvillimin e artit dhe kulturës.
3. TKEKS-së ka si qëllim dhe objekt kryesor të veprimtarisë së tij:
 - a) Nxitjen e zhvillimit të artit, si krijimtari shpirtërore;
 - b) Ruajtjen e identitetit kulturor kombëtar, nëpërmjet studimit, edukimit, prodhimit, paraqitjes dhe shpërndarjes së veprave artistike e kulturore;
 - c) Eksperimentimin e formave të reja të shprehjes skenike;
 - d) Realizimin e veprave artistike të autorëve shqiptarë dhe të huaj, për të gjitha grupet e shtresat sociale;
 - e) Shkëmbimet teatrore ndërkombëtare, turnetë, festivalet, manifestimet intelektuale, riprodhimin audioviziv dhe botimet.

Neni 4

Parimet

TKEKS, në veprimatrinë e tij udhëhiqet nga parimet e ligjshmërisë, pavarësisë, transparencës, profesionalizmit, cilësisë, eficiencës dhe efektivitetit, barazisë, mosdiskriminimit, parimin e mbrojtjes së të dhënave, ruajtjes së konfidencialitetit.

Neni 5

Stema, vula zyrtare dhe logoja

1. "TKEKS" identifikohet me stemën, vulën dhe logon e tij zyrtare.
2. Stema e TKEKS përbëhet nga stema e Republikës dhe shënimet: "REPUBLIKA E SHQIPËRISË, MINISTRIA E KULTURËS, "TEATRI KOMBËTAR EKSPERIMENTAL KUJTIM SPAHIVOGLI"
3. Vula e TKEKS prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 5

Selia

TKEKS është person juridik publik buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën me seli në Tiranë, me adresë: Rruga "Sami Frashëri", ArTurbina.

Neni 6

Kohëzgjatja

TKEKS është krijuar për të ushtruar veprimtarinë në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe me këtë statut, për një afat kohor të pacaktuar.

KREU II

ORGANIZIMI DH FUNKSIONIMI I TKEKS

Neni 7

Struktura organizative

1. Struktura dhe organika e TKEKS organizohet dhe funksionon sipas strukturës dhe organikës të miratuar me urdhërin e Kryeministrit, nr. 201, datë 25.08.2014 "*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Teatrit Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli"*."
2. Struktura e TKEKS -së është e ndërtuar sipas detyrave funksionale dhe përbëhet nga pozicionet si vijon:

- a) Drejtori
 - b) Drejtoria e zhvillimit artistik
 - i. Drejtor – 1
 - ii. Specialistë të edukimit përmes kulturës – 2
 - iii. Trupa artistike – 6 aktorë kategoria I , 4 aktorë kategoria II
 - c) Sektori i skenës
 - i. Specialist skene-1
 - ii. Fonist – 1
 - iii. Teknik i mesëm i specialiteteve të ndryshme - 2
 - ç) sektori i shërbimeve
 - i. Përgjegjës sektori – 1
 - ii. Specialist – 1
 - iii. Magaziner – 1
3. Të drejtat dhe detyrat për çdo pozicion pune, përcaktohen hollësisht në përshkrimet e punës, në kontratat individuale dhe Rregulloren e Brendshme të TKEKS.

Neni 8 Detyrat e TKEKS

TKEKS në ushtrimin e veprimtarisë së tij ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- a) Vendosjen e një dialogu të qëndrueshëm dhe zhvillues mes TKEKS dhe publikut;
- b) Njohjen dhe kultivimin e shijeve të publikut;
- c) Nxitjen e kërimit artistik në fushën e prodhimit teatror;
- d) Theksimin e elementit kombëtar duke rimëkëmbur dhe kultivuar dramën shqipe;
- e) Nxitjen e shkëmbimeve dhe bashkëprodhimeve artistike në planin rajonal dhe ndërkombëtar;
- f) Rritjen profesionale të prapavijës teatrore;
- g) Nxitjen dhe promovimin e brezit të ri të krijuesve teatror;
- h) Çdo detyrë tjetër të përcaktuar me ligj.

Neni 9 Bordi Artistik i TKEKS

1. Bordi Artistik është organ kolegjal vendimmarrës pranë Teatrit Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”, në përputhje me ligjin nr. 10 352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”, ligjin nr.8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” si dhe rregulloren e funksionimit të Bordit Artistik.

2. Bordi Artistik propozohet nga Drejtori i TKEKS-së dhe miratohet nga Ministri përgjegjës për artin dhe kulturën.
3. Bordi Artistik përbehet nga 7 antarë: një përfaqësues nga Ministria e Kulturës, një përfaqësues nga Ministria e Financave dhe 5 personalitete të fushave të ndryshme të artit, jo të punësuar në TKEKS, me një mandat 4 (katër) vjeçar.
4. Mbledhjet e Bordit Artistik thirren, organizohen dhe drejtohen nga Drejtori i TKEKS.
5. Kompetencat dhe mënyra e funksionimit të Bordit Artistik të TKEKS miratohen nga titullari i institucionit.
6. Anëtarët e Bordit Artistik janë figura të shquara me integritet të cilët kanë dhënë kontribut të lartë në fushën e artit dhe kulturës.
7. Anëtarët e bordit deklarojnë se nuk kanë konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik.

KREU III

DREJTIMI, MARRËDHËNIET E PUNËSIMIT DHE DETYRAT E DREJTORIT

Neni 10

Drejtimi

1. TKEKS drejtohet dhe përfaqësohet nga Drejtori, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e TKEKS dhe përgjigjet para ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën.
2. Drejtori i TKEKS-së emërohet dhe shkarkohet nga detyra, me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me vendimin nr.173, datë 7.3.2003 të Këshillit të Ministrave "*Për emërimin, lirin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve, në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të ministrit*".
3. Drejtori duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:
 - a) Të jetë shtetas shqiptar;
 - b) Të ketë mbaruar arsimin e lartë në degët e artit, menaxhimit të artit kulturor;
 - c) Të ketë një përvojë pune jo më 3 vite pune në profesion dhe/ apo përvojë të konsiderueshme në drejtim, menaxhim dhe krijimtari në fushën e artit skenik, si dhe në drejtimin e projekteve kulturore;
 - d) Të ketë përvojë me teatrin e të rinjve dhe në programet e edukimit përmes kulturës;
 - e) Të ketë integritet në jetën publike e të ketë në CV-në e tij pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme ndërkombëtare;
 - f) Të jetë njohës i gjuhës angleze ose i një gjuhe tjetër të BE. Gjuhë të tjera të huaja përbëjnë avantazh.
4. Drejtori shkarkohet nga detyra në rastet kur:
 - a) kryen veprime në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe këtij Statuti;
 - b) nuk realizon objektivat dhe detyrat e përcaktuar në këtë Statut dhe ligjet që mbulojnë veprimtarinë e TKEKS;

- c) dënohet me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale;
- d) bëhet i paaftë fizikisht ose mendërisht për të kryer detyrat e tij;
- e) demton imazhin, interesat ekonomike dhe misionin e TKEKS;
- f) mungon pa arsye në detyrë dhe refuzon të përmbushë detyrimet statutorë e administrative.

Neni 11 **Detyrat e Drejtorit**

Drejtori i TKEKS ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- a) analizon, zbërthen dhe siguron zbatimin e vendimeve lidhur me politikat e ministrisë përgjegjëse për artin dhe kulturën;
- b) është përgjegjës për hartimin e objektivave dhe zbatimin e planeve strategjike në përputhje me objektivat dhe misionin e TKEKS-së;
- c) planifikon, drejton dhe koordinon funksionimin e përgjithshëm të institucionit;
- d) shpërndan punën brenda institucionit dhe siguron arritjen e rezultateve në kohë dhe me cilësi, sipas objektivave të planifikuara;
- e) siguron/garanton që burimet në dispozicion të Institucionit të organizohen në mënyrë që objektivat e saj të realizohen me efektshmëri të lartë, në mënyrë tërësisht të rregullt dhe korrekte;
- f) drejton procedurat administrative për rekrutimin e personelit, në përputhje me nevojat e Teatrit Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli". Drejtori përgjigjet për emërimin, transferimin, marrjen e masave disiplinore apo largimin nga detyra për të gjithë punonjësit e institucionit, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- g) përgjigjet për zgjidhjet ligjrisht të bazuara dhe teknike të problemeve brenda Institucionit, duke bashkëpunuar me të gjitha strukturat që e konsideron të nevojshme;
- h) siguron disiplinën në institucionin që drejton dhe në bazë të legjislacionit në fuqi, brenda kompetencave ligjore, merr masa për çdo punonjës që thyen rregullat në administratën publike;
- i) realizon detyrat e ngarkuara nga ligji, brenda afatit dhe raporton mbi to tek ministri përgjegjës për artin dhe kulturën;
- j) është përfaqësuesi ligjor i institucionit në marrëdhënie me të tretët;
- k) drejton veprimtarinë administrative dhe organizative të institucionit dhe ndjek zbatimin e vendimeve të bordit artistik;
- l) administron burimet financiare të institucionit;
- m) çdo detyrë tjetër të përcaktuar me ligj dhe akt nënligjor;
- n) realizon detyrat e ngarkuara nga ligji, brenda afatit dhe raporton mbi to.

Neni 12 **Marëdhëniet e Punësimit**

1. Punësimi në TKEKS bëhet me kontratë individuale pune në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, që rregullon marrëdhëniet e punës.
2. Rregullimi i marrëdhënieve të punës për sa i përket vlerësimit të performancës, përshkrimit individual të punës, shkeljet dhe masat disiplinore, përcaktohen në Rregulloren e Brendshme të TKEKS.
3. TKEKS vendos marrëdhëniet e punës me punonjësit përmes kontratave me afat të pacaktuar dhe me kohëzgjatje të caktuar, sipas nevojave administrative institucionale.
4. Rregullimi i marrëdhënieve të punës për sa i përket vlerësimit të performancës, përshkrimit individual të punës, shkeljet dhe masat disiplinore, përcaktohen në Rregulloren e Brendshme të TKEKS-së.
5. Afatet dhe procedurat e njoftimit referuar përcaktimeve të Kodit të Punës dhe Kodit të Procedurave Administrative, për çdo rast dhe natyrë të shkeljeve disiplinore, janë si më poshtë:
 - a) Njoftimi për ecurinë disiplinore dhe zhvillimit të seancës dëgjimore i drejtohet me shkrim punonjësit të paktën 72 orë përpara datës së caktuar për takim. Njoftimi drejtohet në vendin e punës ose në adresën e vendbanimit;
 - b) Seanca dëgjimore realizohet në prani të Drejtorit, përfaqësues nga Sektori i Shërbimeve Mbështetëse.
 - c) Gjatë seancës dëgjimore Drejtori, parashtron punonjësit arsyet e vendimit për fillimin e ecurisë disiplinore konkrete dhe të vërtetuar dhe i jep atij mundësinë për tu shprehur.
 - d) Vendimi për dhënien e masës disiplinore njoftohet me shkrim brenda një afati nga 48 orë deri në një javë pas takimit.

KREU IV

ADMINISTRIMI FINANCIAR

Neni 14

Të ardhurat buxhetore

1. TKEKS është një institucion buxhetor shtetëror në varësi të Ministrisë së Kulturës.
2. TKEKS në kuadër të realizimit të projekteve për artin dhe kulturën mund të marrë donacione dhe sponsorizime të ndryshme nga subjekte private ose organizata të ligjshme, shqiptare apo edhe të huaja në kuptim të ligjit nr. 7892, datë 21.12.1994 "*Për sponsorizimet*", i ndryshuar.
3. Fondi për buxhetin e TKEKS miratohet nga Ministri i Kulturës, menjëherë pas miratimit nga Kuvendi të ligjit për buxhetin vjetor.
4. Fondet vjetore të akorduara nga buxheti i shtetit dhe çdo e ardhur e realizuar nga sponsorizimet, donacionet etj, do t'i nënshtrohen rregullave të legjislacionit në fuqi.

5. Të ardhurat buxhetore krijohen dhe administrohen nga TKEKS sipas legjislacionit në fuqi, vendimit nr. 432 datë 28.06.2006, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore”, dhe udhëzimin e përbashkët nr.52 datë 09.02.2015 të Ministrit të Kulturës dhe Ministrit të Financës “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, në institucionet e sistemit të Ministrisë së Kulturës”.

Neni 14

Hartimi i projekt buxhetit

TKEKS, dy herë gjatë vitit kalendarik, paraqet pranë ministrisë përgjegjëse për artin dhe kulturën, projekt buxhetin afatmesëm, të shpenzimeve dhe të investimeve për vitin pasardhës, të shoqëruar me preventivat përkatëse.

Neni 15

Auditimi i TKEKS

Administrimi dhe veprimtaria financiare TKEKS auditohet nga ministria përgjegjëse për artin dhe kulturën, si dhe institucione të tjera të ngarkuara me ligj, për auditim.

KREU V DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 16

Propozimi dhe ndryshimet në Statut

1. Statuti i TKEKS propozohet nga titullari i TKEKS dhe miratohet nga Ministri përgjegjës për artin dhe kulturën.
2. Ndryshimet dhe plotësimet në këtë Statut propozohen nga titullari i TKEKS dhe miratohen nga Ministri përgjegjës për artin dhe kulturën.

Neni 17

Hyrja në fuqi

Ky Statut hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.